



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.28, datë 29. 06. 2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYLLIT PRIVAT ME
PRONAR Z. ARJAN XHA FERLLARI DHE Z. KASTRIOT XHA FERLLARI”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.06.2020, pasi mori në shqyrtim projekt-dokumentacionin e hartuar nga grupi i punës së Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54/e, Ligjin Nr.9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, VKM Nr. 433, datë 08.06.2016. “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish- Komunave/ Bashkive”, VKM Nr.438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, pika Nr. 26, Vendimit Nr. 2, datë 25.09.2005. “Për kthimin e pyjeve” Z. Petrit Xhizdari, të KKKP-ish pronarëve, çertifikatat e pronësisë të lëshuara nga ZVRPP Skrapar për pronarët Z. Arjan dhe Kastriot Xhaferllari

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të mbarështimit të pyllit privat me pronar Z. Arjan Xhaferllari dhe Z. Kastriot Xhaferllari.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Shërbimit Pyjor.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 10 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

